



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:130097

Datë: 07.12.2022

Numri i dokumentit: 03725804

**P.nr.100/2022**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit A. H. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm PP/II.nr.883/2022 të datës 23.06.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj, dhe të akuzuarit, më datë 05.12.2022, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari,

**A. H.**, nga i ati A., e ëma D., e gjinisë K., i lindur më datë ... në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit, ku edhe banon, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar i ati i dy (2) fëmijëve, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

### Për shkak se:

**I.** Me datë 10.01.2022, në shtëpinë e tij në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës Nr.05/L-85, ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K.-it, është konstatuar se i pandehuri, në njehsorin elektrik me numër 34586371, ka qenë i bllobuar, mirëpo ka një ndërprerës 1/0/2, në drejtim të KKK, brenda, ku në pjesën e ndërprerësit 1 energjia kalon përmes njehsorit, ndërsa në ndërprerësin 2 energjia është jashtë majtas, në këtë mënyrë është furnizuar pa matje, ku me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar K. – distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në shumën prej 264.87 euro.

**-Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 46 par.1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

## **DËNIMIN ME KUSHT**

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara K. – Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të shpenzimeve paushallë të paguaj shumën prej (30) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

### **1.Ecuria e procedurës penale**

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.883/2022 të datës 23.06.2022, kundër të pandehurit A. H. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 05.12.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj, dhe i akuzuari.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cila ka qëndruar në tërësi pranë saj. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

### **2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë.**

I akuzuari ka deklaruar se: e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndjen veten fajtor për këtë veprë penale për të cilën ngarkohet dhe se ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, dhe i propozoi gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit pasi që është i gjendjes së dobët ekonomike.

Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj ka deklaruar se: duke pasur parasysh se i akuzuari e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, i njëjti ka kuptuar natyrën, pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë u bë vullnetarisht nga i pandehuri pas shtjellimit të mjaftueshëm nga gjykata, po ashtu faktin se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes, provave materiale dhe personale që përmban aktakuza në bazë të të cilave edhe është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj aktakuze, ku edhe përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale për të cilën ngarkohet, po ashtu edhe faktin se aktakuza është e ligjshme dhe provat të cilat i përmban janë prova të nxjerra në bazë të rregullave të përgjithshme mbi prova. Prokuroria e Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 326 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari A. H. me dashje ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 314 par.6 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale vjedhja e shërbimeve e kryen: “Për qëllime të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar.”, lidhur me paragrafin 1 ku parashihet se: “**Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.**”

### 5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

-Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike të njehsorit me numër: 0944188 të datës: 10.01.2022;

-Fatura mbi kalkulimin e rikthimit të humbjeve me numër: DPR22HP2210375 të datës: 13.01.2022

-Foto-dokumentacioni, dhe shkresat tjera në lëndë;

Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

## **6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.**

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

## **7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.**

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 453 par.3 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.100/2022, me datë 05.12.2022**

**Sekretare juridike**  
**Shemsije Shehu**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Mizahir Shabani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.